



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA –REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Në çështjen juridike të:

AC-I-17-0701

Xh. K, Malishevë.

Ankuesi/Paditësi

i cili përfaqësohet nga zyra e avokatëve, përmes av. B. I, Prishtinë.

Kundër:

NSH

E paditura

Administruar nga Agjencia Kosovare e Privatizimit, rr "Agim Ramadani " nr.23,Prishtinë.

Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), i përbërë nga Ilmi Bajrami , gjyqtar kryesues, Sabri Halili dhe Mr.sc. Sahit Sylejmani, gjyqtarë, duke vendosur sipas ankesës së paditësit të paraqitur kundër Aktgjykimit të Kolegjit të Specializuar të DHPGJS-së, C-IV-14-3891 të datës 29 nëntor 2017, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 21/11/2018, lëshon këtë:

A K T G J Y K I M

- 1.** Ankesa e paditësit refuzohet si e pabazuar.
- 2.** Vërtetohet Aktgjykimi i Kolegjit të Specializuar të DHPGJS-së, C-IV-14-3891 të datës 29 nëntor 2017.

3. Asnjëra palë nuk ka të drejtë në rimbursimin e shpenzimeve procedurale

Rrethanat procedurale

Më 25 prill 2014, **Xh. K**, dhe ish-punëtorët e NSH-së (në likuidim), të përfaqësuar nga av. B.I, parashtruan ankesë në DHPGJS kundër vendimeve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtutjeshëm: AKP), PRZ-008-0304 dhe PRZ008-0305, të dyja të datës 16 dhjetor 2013.

Ankesa e bashkuar e parashtruar me 27 janar 2014 ishte e ndarë në lëndë të veçanta dhe ankesa e ankuesit ishte ri-regjistruar më 25 prill 2014 me numër C-IV-14-3891.

Në ankesën e parë (kundër vendimit PRZ008-0304), me të cilin kërkesa e paditësit për kompensimin e për tri (3) paga në shumën prej 360 euro ishte refuzuar si e pa bazuar pasi që kërkesa ishte vlerësuar se është parashkruar. Në ankesën e dytë kundër vendimit PRZ008-0305 me të cilin kërkesa e paditësit për kompensimin për paga të pa paguara në shumën prej 4.114 për periudhën 23/03/1992 deri më 30/06/1999 euro gjithashtu ishte refuzuar si e pa bazuar pasi që kërkesa ishte vlerësuar se është parashkruar.

Në vendimin e kundërshtuar Autoriteti i Likuidimit vuri në dukje se, sipas nenit 608 të Ligjit për Punën e Bashkuar (Gazet Zyrtare nr.53/1976), pagesat e pagës, apo kërkesave tjera të punëtorit që burojnë nga marrëdhënia e punës do të parashkruhet për tre vite”

Përfundimi paraprak i Autoriteti të Likuidimit është se kërkesat ishin parashkruar më 23 mars 1995.

Tutje, Autoriteti i Likuidimit thekson së Këshilli i punëtorëve i NSH më 11 gusht 2005, ka aprovuar kërkesën e ankuesit për pagesën e pagave në shumën prej 4.114 euro dhe si rezultat i saj, kërkesa është parashkruar me 11 gusht 2008.

Bazuar në arsyet e lartcekura, kërkesat e ankuesit ishin të refuzuara si të pavlefshme.

Ankuesi në ankesë theksoi se NSH është ndërmarrja në pronësi shoqërore (NSH) e cila ishte shitur përmes privatizimit më 04 nëntor 2009.

Më 06 nëntor 2009 ankuesi ka pranuar njoftimin nga punëdhënësi në lidhje me ndërprerjen e marrëdhënies së tij të punës.

Në këtë njoftim mes tjerash thuhej, si në vijim:

“Shumat e papaguara-pagat sipas kontratës suaj të punës me punëdhënësin do të mbesin nën përgjegjësi të punëdhënësit. Kërkesat e tilla do të shqyrtohen sipas procedurave të likuidimit dhe ju do të kontaktoheni për fillimin e këtyre procedurave” Ankuesi thekson më tutje, se ai ka pasur arsye të justifikueshme të besoj se punëdhënësi/Autoriteti i Likuidimit do ta kontaktoj atë në lidhje me pagat e papaguara siç përshkruhej në shkresën për ndërprerjen e marrëdhënies së punës. Ankuesi iu referua gjithashtu vendimit të nxjerr nga Këshilli i Punëtorëve i datës 11 gusht 2005. Në këtë vendim, Ankuesi i ishte aprovuar shuma e pagave të papaguara pasi që ai ishte larguar si rezultat i masave të dhunshme të Serbisë. Ankesës i ka bashkangjitur : Prokurën Speciale të zyrës së avokatëve sh.p.k., Njoftimin mbi Likuidimin e N.SH dt.06/11/2009, Vendimin PRZ008-0304, PRZ008-0305.

Me mbrojtën e vet të datës 27 qershor AKP-ja pohoi se ankesa nuk ishte parashtruar brenda afatit prej 30 ditëve si përcaktohet me nenin 37.7 të Shtojcës së Ligjit nr.04/L-034. Vendimi i Autoritetit të Likuidimit është i datës 18 dhjetor 2013, parashtruar me 25 prill 2014, çfarë nuk është brenda afatit prej 30 ditësh.

Në lidhje me njoftimin për ndërprerjen e marrëdhënies së punës të datës 06 nëntor 2009, AKP-ja përmend se njoftimi në fjale është një letër identike e dërguar tek shumica e punëtorëve pa vlerësuar situatën faktike ligjore kundër NSH-së. Tutje, AKP-ja mbështetë opinionin se njoftimi në fjale është ndërlidhur vetëm dhe ekskluzivisht me përpilimin e të ashtuquajturës “liste e 20%-shit”.

Ankuesi në përgjigjen e vet ndaj mbrojtjes së AKP-së të datës 13 korrik 2017, përsëriti qëndrimin e tij se Ligji për Punën e Bashkuar, neni 608 nuk është i aplikueshëm në Kosovë.

Në lidhje më Letrën e ndërprerjes së marrëdhënies së punës të datës 06 nëntor 2009, ankuesi thirret në Aktvendim e Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së AC-I-14-0323 të datës 12 mars 2005. Ankuesi citon Aktvendimin si në vijim: "...Kolegji i Apelit nuk pajtohet me pretendimet e AKP-së se Njoftimi (Letra e ndërprerjes së marrëdhënies së punës) e datës 17.11.2006, e dërguar tek paditësi ka pasur qëllim që ta njoftoi atë lidhur më të drejtën për 20%...por në këtë letër gjithashtu është cekur e drejta për të kërkuar pagat si dhe kërkesat tjera kreditore të cilat paditësi mund t'i ketë ndaj ndërmarrjes në likuidim."

Qëndrim i ankuesit është që letra është vlerësuar si pranim i obligimit për përmbushjen e të gjitha borxheve të mbetura të NSH-së ndaj kreditorit dhe kjo e drejtë nuk mund të jetë subjekt i institutit juridik të parashkrimit.

E paditura ka dorëzuar kundërpërgjigjen e vet me 27 korrik 2017 përmes së cilës e paditura konfirmon pretendimet dhe mendimet ligjore të paraqitura në mbrojtjen.

Me 29 nëntor 2017, Kolegji i Specializuar me Aktgjykim, C-IV-14-3891, e refuzoi ankesën si të pabazuar dhe vërtetohen vendimet e Autoritetit të Likuidimit si të drejta dhe të bazuara në ligj. Duke u bazuar në nenin 14.4 të Ligjit nr.04/L-033 të DHPGJS për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, në lidhje me neni 398 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, gjykata vlerëson së faktet relevante të lëndës janë të pakontestueshme kërkesa e ankuesit për paga të papaguara veçse ishin parashkruar, pasi që njoftimit lidhur me këtë çështje të datës 06 nëntor 2009, ankuesi e ka pranuar në nëntor të vitit 2009, Fakt i pa kontestuar nga palët, kjo kërkesë do të kishte efekt po të ishte pranuar para afatit të parashkrimit (11 gusht 2008). Në lidhje me kërkesën e ankuesit rreth pagave për tre muaj, në plotësim të asaj që është arsyetuar më lart, gjykata gjen së kërkesa është e pabazuar për faktin se Shtojca e Ligjit për AKP-në(Nr.04/L-034) neni 40, paragrafi 1.6.1 i referohet vetëm prioritetit të tre (3) pagave të fundit të papaguara. Prandaj, duke u bazuar në neni 70.4 të Shtojcës së Ligjit të DHPGJS(nr.04/L-044) ankesat refuzohen si të pabazuara.

Më 18 dhjetor 2017, Paditësi parashtroi ankesë (më tutje ankuesi) kundër Aktgjykimit C-IV-14-3891, (më tutje Aktgjykimi ankimuar) për shkak të konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me pretendimet se nuk ka mbështetje ligjore për shkak se sipas dispozitave ligjore në fuqi Autoriteti i Likuidimit duhet të jetë i pavarur në kryerjen e punës së tij, që do të thotë se nuk duhet të ia mbaj anën ndërmarrjes së punëtorit, ndërsa sipas dispozitave të LMD-së, të drejtën për tu thirrë në parashkrim e kanë vetëm palët ndërgjyqës. Po ashtu, duke u bazuar në neni 362 i LMD-së thotë se "Parashkrimi lind kur të ketë skaduar dita e kohës së caktuar me ligj", ndërsa dita e kohës së caktuar me ligj ë rastin konkretë është momenti kur është hapur procedura e likuidimit dhe në rastin konkret nuk mund të bëhet fjale për parashkrim të kërkesës.

Pastaj, Neni 387 të LMD-së thotë: "Ndërprerja e parashkrimit, Pohimi i borxhit"

1.Parashkrimi ndërpritet kur debitori e pohon borxhin.

2.Pohimi i borxhit mund të bëhet jo vetëm duke i dhënë deklaratë kreditorit por edhe në mënyre indirekte siç janë dhënia e kësteve, pagimi i kamatave, dhënia e sigurimit". Pra, pohimi në mënyrë indirekte është bërë nga ana e zyrtarëve të AKP-së, të cilët në mënyrë të vazhdueshme i kanë thënë punëtorëve se te gjitha kërkesat e tyre do të trajtohen në procedurën e likuidimit dhe se te gjitha borxhet që ndërmarrja u `a ka atyre do të paguhen me fondet që do te dalin nga privatizimi dhe likuidimi i ndërmarrjes. Në këtë pikë, Gjykata nuk e ka vërtetuar fare gjendjen faktike duke bërë që edhe te drejtën materiale ta zbatoje gabim.

Si përfundim, ankuesi kërkon nga Gjykata me Aktgjykim ti aprovohet ankesa si e bazuar, të ndryshohet, Aktgjykimi i ankimuar dhe rasti të kthehet në rivendosje, të detyrohet AKP të kompensoj ankuesin në përputhje me tarifën e OAK.

Më 30 prill 2018,AKP-ja parashton përgjigje në ankesë kundër Aktgjykimit të ankimuar ankuesi në ankesë në Apel nuk ka përsëritur të njëjtat argumente si në Ankesë, te cilat me të drejtë Gjykata nuk i ka pranuar. Gjithashtu, thekson se në njoftimin 06.11.2009 nuk përbën njohje borxhi sepse nuk përmban një identifikim të borxhit dhe njihje te tij , por thjeshtë një njoftim mundësinë që ka pasur për të dorëzuar një kërkesë gjatë likuidimit. AKP-ja, mbështet Aktgjykimi i ankimuar, duke e konsideruar si të drejtë dhe të ligjshëm.

AKP-ja kërkon nga Kolegji i Apelit që me Aktgjykim ta refuzoj ankesën e paditësit dhe të vërtetoj Aktgjykimi i ankimuar.

Arsyetimi Ligjor

Ankesa refuzohet si e pa bazuar.

Në bazë të nenit 69 të Ligjit nr.06/L-086 për DHPGJS-së Kolegji i Apelit vendosi të mos mbajë pjesën gojore të procedurës.

Kolegji i Apelit pasi që shqyrtoi në tërësi pretendimet ankimore, provat në shkresat e lëndës dhe Aktgjykimin e ankimuar ka ardhur në përfundim se i njëjti nuk është përfshi në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore për të cilat gjykatat duhet të kujdeset ex officio. Gjithashtu pasi që shqyrtoi në tërësi pretendimet ankimore, provat në shkresat e lëndës gjeti se ankesa është e pabazuar.

Në këtë lëndë nuk është kontestuese fakti se ankuesi nuk ka punuar në NSH në periudhën kohore kur i kërkon pagat dehe se nga puna ishte larguar për shkak të zbatimit të masave të dhunshme në NSH-ë. Ky ankues njoftimin për ndërprerjen e marrëdhënies së punës nga AKP-ja e ka pranuar me datë 06 nëntor 2009, para fillimit të procedurës së likuidimit të NSH-së, e cila dëshmi megjithatë nuk mund të ketë ndikim për një rezultat tjetër të dhënë, nga ai që e ka dhënë Kolegji i Specializuar në Aktgjykimin e ankimuar. Një qëndrim të tillë për një kërkesë të njëjtë të një ankuese të njëjtës NSH, Kolegji i Apelit e ka marrë edhe në rastin AC-I-16-0189.

Parashtresa me numër PRZ008-0304, drejtuar Autoritetit të Likuidimit me të cilën ai kërkon pagat e pa paguara është e datës 09 gusht 2013, gjithashtu, parashtresa me numër PRZ008-0305, drejtuar Autoriteti të likuidimit apo një organi kompetent me të cilën ai kërkon pagat e pa paguar për periudhën 23/03/1992 deri më 30/06/1999 është e datës 09 gusht 2013.

Kolegji i Apelit nuk e pranon pretendimin e ankuesit se afati i parashkrimit rrjedhë nga dita kur vendimi për ndërprerje të marrëdhënies së punës bëhet i plotfuqishëm pasi që tashmë kërkesa ishte e parashkruar, dhe njoftimi i AKP-së për ndërprerjen

e marrëdhënies së punës në këtë rast nuk mund ta ndërprejë parashkrimin. Për me tepër edhe sikur personalisht të ishte informuar ankuesi për fillimin e procedurës së likuidimit procedura e likuidimit kishte filluar më datën 23 maj 2013 nuk do të sillte rezultat tjetër për shkak se tashmë kërkesa ishte parashkruar sikurse edhe Vendimi mbi pranimin e borxhit nga Këshilli i Punëtoreve të vitit 2005.

Kolegji i Specializuar i DHPGJSK-së i kishte refuzuar ankesat si të pa bazuara dhe kishte vërtetuar Vendimin e AKP-së - Autoritetit të Likuidimit nr. PRZ008-0304 dhe Vendimit nr. PRZ008-0305 si i drejtë dhe të bazuar në ligj. Sipas Kolegjit të Specializuar, neni 608 i Ligjit për Punën e Bashkuar (G. Zyrtare nr.53/76 i aplikueshëm) përcakton se: *"Pagesa e shumës së pagës apo rrogës, apo secilës kërkesë tjetër të punëtorit që rrjedh nga marrëdhënia e punës do të jetë e parashkruar për 3 vjet"*. Ankuesi, ankesës nuk ia ka bashkangjitur asnjë provë të besueshme me të cilën do të dëshmonte se ai me kohë i është drejtuar ndonjë organi të NSH-së, për realizimin e të drejtës së pretenduar nga marrëdhënia e punës. Ai gjithashtu nuk ka dorëzuar asnjë provë se ndonjëherë i është drejtuar ndonjë gjykatë kompetente me padi lidhur me këtë çështje, gjegjësisht 3 vite pasi që NSH-ja ka ndërprerë pagesën e të ardhurave personale të tij.

Neni 608 i Ligjit të Punës së Bashkuar(G. Zyrtare nr.53/76) në të cilin ishte bazuar vendimi refuzues, ishte shfuqizuar me Ligjin e Punës nr. 03/L-212 i cili ka hyrë në fuqi më 01 nëntor 2010, dhe i cili në dispozitat kalimtare përcakton saktë shfuqizimin e të gjitha ligjeve ekzistuese të punës në Kosovë. Megjithatë Ligji i Punës nr. 03/L-212 nuk parasheh afate të parashkrimit të pagesave të ardhurave. Prandaj duhet të aplikohen afatet e përgjithshme të parashkrimit për detyrimet civile. Këto rregulla mund të gjinden në Ligjin mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD) nr. 690 i datës 30 mars 1978, i cili ishte në fuqi deri në hyrjen në fuqi të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD). Ndërsa në pajtim me nenin 372, paragrafi 1 i LMD-së parashkrimi i kërkesave periodike siç janë pagat, është tri (3) vjet: njëjtë sikurse në nenin 353, paragrafi 1, gjegjësisht në nenet 352 dhe 354, paragrafi 1 dhe 2 i LMD-së. Me sa po shihet afati i parashkrimit për paga ka qenë dhe ende është tre (3)vite.

Vlen të theksohet se ankuesi në ankesën e dytë para Kolegjit të Specializuar nuk i referohet shpërblimit për ndërprerje të parakohshme të Kontratës së punës tri paga

por kjo i referohet Vendimit të Autoritetit të likuidimit nr. PRZ008-0305 me të cilin Vendim kërkesa për paga të pa paguara për periudhën kohore 13 janar 1992 deri më 30 qershor 1999 ishte refuzuar për shkak të parashkrimit.

Në procedurën ankimore nuk parashtrohet asnjë pretendim ankimor lidhur me kërkesën për shpërblimit për shkak ndërprerjes së parakohshme të Kontratës së punës. Prandaj edhe Kolegji i Apelit nuk mund të deklarohet lidhur me këtë kërkesë. Kolegji i Apelit refuzon edhe kërkesën e avokatit për mbulimin e shpenzimeve procedurale sipas tarifës gjyqësore.

Sipas nenit 11 të Ligjit të DHPGJS pala e pasuksesshme paguan shpenzimet procedurale përfshirë edhe tarifën gjyqësore të palës tjetër. Ankuesi është palë e pa suksesshme në këtë çështje prandaj shpenzimet gjyqësore janë barrë e tij. E paditura nuk ka kërkuar mbulimin e shpenzimeve gjyqësore andaj ankuesi nuk ngarkohet me shpenzimet e gjyqësore të paditurës.

Andaj, Kolegji i Apelit vendosi si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

Taksat gjyqësore

Ankuesi lirohet nga obligimi i pagesës së taksës gjyqësore për procedurën ankimore, pasi që me 07/03/2018 ka paguar taksën gjyqësore.

U vendos nga Kolegji i Apelit i DHPGJS-së më 21/11/2019.

Ilmi Bajrami, Gjyqtar kryesues